



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

RAPORT VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK  
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2021

*Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (vjetor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrave dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.*

**1. Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e në vijim, MSHMS) ka përbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për vitin 2021, janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENKP) dhe/ose aktiviteteve të tjera konsultative, aktet e mëposhtme:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030”;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 700, datë 25.11.2021 “Për miratimin e Planit e Veprimit për Personat e LGBTI-së në Shqipëri 2021–2027”
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 16.11.2021 “Për miratimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026”;
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.1.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025
6. Ligji Nr. 129/2021 "Për statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës"

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar (vitin 2020), ku pjesëmarrja e aktorëve ishte mesatarisht e ulët është përmirësuar në të gjitha aspektet, duke patur një numër të madh aktorësh të përfshirë, sidomos nga organizatat joqeveritare.

Takimet konsultative janë zhvilluar nëpërmjet platformave të ndryshme ndër to RENKP, aplikacionet online dhe tryezat e përbashkëta duke respektuar masat e ndërmarra për parandalimin e Covid-19. Në këtë kontekst, indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) është 100 % pasi të gjithë aktet e konsultuara i janë nënshtruar takimeve publike. (IPM = 6/6\*100 = 100%)

Sfidat mbeten në rrafshin e përfshirjes së aktorëve joqeveritarë. Ndonëse ka patur përmirësime (sikurse trajtohet me gjerë në vijim), mund të bëhen akoma më shumë përmirësime. Përdorimi i takimeve konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë forma efektive të konsultimit pasi avantazhojnë pjesëmarrje të plotë të aktorëve duke shpenzuar më pak nga koha e tyre.

## **2. Analiza e konsultimeve të kryera**

### ***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

#### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Numri i akteve të miratuara si nismë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021 është 77. Ndarja e natyrës së akteve të miratuara për vitin 2021 është si më poshtë:

1. 17 janë Akte Normative, qëllimi i të cilave, kryesisht, ka qenë miratimi i tekstit dhe i marrëveshjeve të nënshkruara për furnizimi me vaksina anticovid, për të cilat aplikohet përjashtimi sipas shkronjës “ç”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik” ;
2. 40 janë Vendime të Këshillit të Ministrave, prej të cilave:
  - 4 janë miratim i marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat sipas shkronjës “b”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi;
  - 28 janë vendime me karakter të përgjithshëm, të cilat sipas shkronjës “c”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi.
  - 5 janë vendime me rëndësi strategjike .
3. 20 janë Ligje, nga të cilat:
  - 1 Ligj, i cili i është nënshtuar konsultimit publik për arsye se parashikon risi lidhur me trajtimin e fëmijëve prindërit e tyre kanë humbur jetën në kushte të caktuara.
  - 17 prej tyre kanë qenë miratimi i akteve normative, të cilat kanë miratuar tekstin dhe marrëveshjen e nënshkruar për furnizimin me vaksina anticovid, sipas procedurës së parashikuar nga Neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për shkak sekretit tregtar nuk mund të publikoheshin
  - 2 prej tyre janë ratifikimi i dy marrëveshjeve të tjera jo të lidhura me vaksinat, të cilat janë të përjashtuara për shkak të shkronjës “b” të Nenit 4, të Ligjit.

#### ***2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?***

Janë konsultuar të gjitha aktet mbi të cilat bie detyrimi ligjor për konsultim publik, në total 6 akte.

*2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Është konsultuar vetëm një akt, i shoqëruar me VNR. Ai është Ligji Nr. 129/2021 "Për statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës". Për aktet e tjera nuk aplikohet VNR.

*2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2021 për MSHMS parashikon 14 akte. Nga këto, janë përdorur kriteret përjashtuese për konsultimin publik për 9 akte. Arsyeja kryesore e moskonsultimit të tyre është të qënit akte administrative normative të përgjithshme, të cilat nuk janë projekte strategjike apo ligje.

Ritheksojmë se PPAP për 2021 konsiderohet se ka 14 projektakte, ku 5 prej tyre duhet t'i nënshtrohen konsultimit publik, në vijim të rishikimit të këtij plani.

*2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Aktet e konsultuara janë një projektligj dhe pesë projektvendime me rëndësi strategjike.



*2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Po, në raport me vitin e kaluar situata e konsultimit publik të projektakteve është përmirësuar për arsye se numri i akteve të parashikuara për konsultim publik është rritur ashtu si dhe numri i aktorëve të përfshirë. Gjithashtu, edhe numri i komenteve të përcjella nga aktorët joqeveritarë është rritur.

Për vitin 2020, ishin parashikuar 14 akte (dy prej të cilave u hoqën nga PPAP) dhe për 12 prej tyre u aplikuan kriteret përjashtuese. Ndërkohë për vitin 2021, ishin parashikuar 14 akte dhe për 9 prej tyre u aplikuan kriteret përjashtuese.

Trendi është pozitiv për sa i përket përfshirjes së akteve që i nënshtrohen konsultimit publik.

Më poshtë, rezultatet i paraqesim edhe me anë të grafikëve:



## 2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)


Për të gjithë projekttaktet e konsultuara janë përdorur tre metoda konsultimi: tryeza e rumbullakët (në respektim të amasave anticovid, në pjesën më të madhe janë përdorur platforma online si Zoom), email-i dhe RENjKP.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi më shumë komente ka qenë tryeza e rumbullakët, e pasuar nga email-et dhe ajo më pak e përdorura është RENjKP. Pozitive për vitin 2021, është përdorimi i RENjKP nga një organizatë joqeveritare.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?


Po, institucioni organizoi takime paraprake për të diskutuar të gjitha projekttaktet përpara se të prodhonte një draft të gatshëm për konsultim.



### 2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Të gjitha projektaktet janë konsultuar për më shumë se 20 ditë. Periudha më e gjatë e konsultimit ka qenë ka qenë 12 muaj dhe më e shkurtra dy muaj e gjysmë.



2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Periudha mesatare e konsultimit ka qenë përafërsisht 8 muaj.


2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata është përmirësuar në raport me vitin e kaluar për dy arsye kryesore: së pari numri i akteve të konsultuara është rritur dhe së dyti kohëzgjatja e konsultimeve ka qenë më e madhe, me qëllim përfshirjen e sa shumë komenteve nga aktorët pjesëmarrës.

### 2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Numri total i aktorëve joqeveritarë të përfshirë gjatë konsultimit është 32. Numri i ekspertëve të jashtëm është 15.



*2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Grupet e punës kanë përfshirë anëtarë nga MSHMS dhe nga institucione qendrore dhe ekspertë të jashtëm, të mundësuar nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare si UN Women, UNDP dhe UNICEF.

*2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Palët e interesuara dhe që kanë dhënë aktivisht kontribut, janë përafërsisht 230. Kjo për arsye se një pjesë e tyre janë konsultuar për disa projektakte. Për shembull, Qendra AËEN është konsultuar edhe për Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030” edhe për Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 700, datë 25.11.2021 “Për miratimin e Planit e Veprimit për Personat e LGBTI-së në Shqipëri 2021–2027”.

*2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Shifra prej 230 aktorësh përfshin organe të administratës publike, vendore dhe qendrore, ekspertë individualë dhe organizata të shoqërisë civile.

*2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Po, janë përfshirë më shumë aktorë, sidomos anëtarë të organizatave të shoqërisë civile. Ndërkohë formatet për përgatitjen e akteve kanë kërkuar një punë më të specializuar prandaj janë përfshirë përveçse institucioneve shtetërore edhe ekspertë individual të fushës.

## 2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra



### 2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?



Në total, janë marrë 173 komente. Numri i lartë i komenteve ka qenë për Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 16.11.2021 “Për miratimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.1..2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025”.

Numri mesatar i komenteve ka qenë 22 komente për projektakt.

### 2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Në total, janë pranuar 129 komente, janë refuzuar 16 komente dhe pranuar pjesërisht 20 komente. Në këtë kontekst, treguesi IACCEPT është 87.38% ( $149/173 \cdot 100 = 86.12\%$ ).





### 2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në raport me aktet e konsultuara në vitin e kaluar, interesi i organizatave të shoqërisë civile është rritur. Numri më i lartë i komenteve vjen sërish nga organet e administratës publike megjithatë ka një tendencë në rritje të përcjelljes së komenteve nga OSHC si dhe tendencë pozitive për të pranuar komentet e tyre nga ana e Ministrisë.

### 2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

MSHMS ka ndryshuar vetëm një VNR, konkretisht, Ligjin Nr. 129/2021 "Për statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës".

## 2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

### 2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

### 2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Institucioni ka publikuar 6 raporte të konsultimit publik.

## 2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c).

MSHMS vlerëson se konsultimi i të gjashtë dokumenteve të miratuar për vitin 2021, që i janë nënshtruar konsultimit publik ka qenë në nivel shumë të mirë. Në konsultimin e tyre janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh. Dokumenti ka patur forume të ndryshme



konsultimi, si RENjK, email dhe Zoom e nëpërmjet tyre janë sjellë komente dhe feedback nga institucionet dhe shoqëria civile si dhe ndërgjegjësimin për çështjet në fusha të ndryshme të aktivitetit shoqëror.

Sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose jo dhe pse.

Gjithashtu, raportet e konsultimit publik janë publikuar në RENjKP, në seksionet e secilit prej akteve. Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit qeveritar, sigurohet informacion i mjaftueshëm për konsultime të gjera me palët e interesit si dhe ruhen prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, nëpërmjet publikimit të tyre në RENjKP. Gjithashtu, një shkallë e mirë e reflektimit të reagimeve të palëve të interesuara pasqyrohet në draftin e ri. Linqet e tyre e publikimit të raporteve janë si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 700, datë 25.11.2021 “Për miratimin e Planit e Veprimit për Personat e LGBTI-së në Shqipëri 2021–2027”  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/406>
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 16.11.2021 “Për miratimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026”  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/408>
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.1.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025”  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/359>
6. Ligji Nr. 129/2021 "Për statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës"  
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/407>

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat mbeten përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve dhe shoqërisë civile, duke u trajnuar për çështjet e legjislacionit të aksesueshmërisë sipas fushave dhe si rrjedhojë

komentet dhe monitorimin e aktiviteteve të Planit; ndërtimi dhe forcimi i mekanizmave për zbatim kur janë më shumë se një aktor përgjegjës.

Takimet konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë te vlefshme sepse kursejnë kohën e pjesëmarrësve dhe sigurojnë pjesëmarrje pothuaj të plote të të ftuarve.

Një trend pozitiv është numri i lartë i pjesëmarrësve të pranishëm (jo thjesht të ftuar). Kjo tregon interes nga popullsia për të diskutuar mbi çështjet madhore të shoqërisë. Sidoqoftë mbetet sfiduese që të pranishmit ta shprehin angazhimin nëpërmjet komenteve dhe jo thjesht pjesëmarrjes. Më poshtë paraqesim një grafik i cili tregon diferencën midis të pranishmëve në takim dhe organizma që aktivisht kanë kontribuar.

